



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHM TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 09.08.2022 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Ekrem Ymeri, Arbnora Hajredini, Jakup Demiri Liridona Bislimi, Sejdi Emimi, Nexhat Halili, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Majlinda Shabani, Taulant Haxhiu, Vilsona Maliqi-Salihu, Veton Ramadani, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi, ndërsa mungoj Taibe Ibrahimimi, Zyrafete Rama, Musli Neziri, Lindita Demelezi, Sokol Shaqiri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 22 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita e mirë se keni ardhur në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vitisë, të ftuar me kërkesën e grupit parlamentarë të Lidhjes Demokratike, në bazë të nënshkrimeve që më është bërë një kërkesë për një seancë të jashtëzakonshme 1/3 e këshilltarëve komunal na e mundësojnë për një seancë të tillë. Në nenin 44, paragrafi 44.1 dhe 44.4 të Ligjit numër 03/L-040 të Vetëqeverisjes Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës numër 28/15 qershor 2008 nenit 31 paragrafi 31.1 të statutit të Komunës së Vitisë me numër 01013/492, me datën 21.04.2011, të nenit 6 të Udhëzimit Administrative të MAPL-së me numër 02/2015 për mbetjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 2 të rregullores për punën e Kuvendit Komunal të Vitisë numër 01013/594, të datës 02.05.2014, kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, kryesuesi i kuvendit kam bërë ftesë me rendin e ditës

R e n d d i t e

- 1. Diskutim dhe miratimin e një deklarate të përbashkët drejtuar Institucioneve Qendrore të Republikës së Kosovës, për përfundimin sa më parë të punëve në ndërtimin e SHFMU “Halil Alidema” në Pozharan dhe ndërtimin e çerdhes se re në Komunën e Vitisë.**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me këtë rend dite kemi pas kërkesën nga grupi parlamentarë i LDK-së dhe ne seancat e jashtëzakonshme e dini që caktohet rendi i ditës me kërkesën që është bë, vetëm ajo pikë bëhet, nuk ka pika të tjera, sepse është e jashtëzakonshme. Parimisht duhet me ardh te diskutimi, mirëpo shkojmë me miratim të rendit të ditës, sepse është kërkesë. 21 janë prezentë, 21 janë pro, 0 kundër, 0 abstenim. Me gjithë të pranishmit miratohet rendi i ditës. Para se me ardh në seancë kemi pas takim edhe me shefat e grupeve, Ali Bajrami LDK, Jakup Demiri VV, Taulant Haxhiu PDK, dhe në kuadër të diskutimit na ka shoqëru edhe nënkryetari me na ndihmu në kërkesën e hartimit të një deklaratë të përbashkët, që do t'i drejtohem institucioneve të Republikës së Kosovës që të përshejtohen punët për realizimin e projekteve, mbarimin e shkollës fillore në Pozheran dhe fillimin e çerdhes në Viti . Unë me fillim para se me hapë debatin nga një kopje të deklaratës e kemi shpërnda. Kërkojë nga shefat e grupeve të deklarohen.

z.Ali Bajrami: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit! Me grumbullimin e 10 nënshkrimeve nga grupi parlamentarë i LDK janë plotësua të gjitha kushtet ligjore për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme me rendin e ditës që e ceki dhe kryesuesi. E kemi pa të nevojshme ta thirrjmë një seancë pikërisht me qëllimin më të mirë të mundshëm që kemi rreth përfundimit të shkollës në Pozheran “Halil Alidema” dhe çerdhes së fëmijëve në Viti. Ajo çka kërkohet nga ky takim, që të dalim në mbështetje të kësaj deklaratë. Qëllimi i thirrjes së kësaj seance është që të bëjmë një zgjidhje aq sa kemi mundësi me hapësirën ligjore si pushtet lokal dhe si organ ligjvënës në Komunën e Vitisë rreth shkollës Pozheranit dhe çerdhes, që edhe shkolla e dimë se në çfarë gjendje është tu zhvillu procesi mësimor. E dimë që ata nxënës kanë nevojë shumë me anën e kësaj deklaratë, ne si LDK e mbështesim, do ta votojmë pro. Një ashtu edhe sa i përket çerdhes, i di problemet, vështirësitë deri sa e kemi caktuar lokacionin, e di edhe ku e kemi caktuar dhe si grup kërkojë që edhe për shkollën e Pozheranit edhe çerdhen e Vitisë me deklaratën që do t'i drejtohem nivelit qendrorë, kërkohet zgjidhje sa më e shpejtë për të mirën e atyre nxënësve dhe për të mirën e fëmijëve tanë që kanë nevojë për çerdhe. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne si subjekt politikë i Lëvizjes Vetëvendosje mbështesim, por vetëm te teksti, se e përmendet që mundemi me ndryshu. Po e lexoj këtu, kjo neglizhencë dhe mos efikasitet në përpunimin shprehë shqetësimin e përfaqësuesve institucionale lokale, vetëm se kisha thanë që nga fillimi dhe deri më sot për me përfunduar si projekt sa më shpejtë që është e mundur. Po këtu shënohet se që nga fillimi ky projekt ka pas telashet e veta. Edhe një deshta me thanë, edhe diçka, perime po me vjen keq, që sot mirë që janë mediat, po e patëm një seancë para 1 jave, se di kur e patëm, i kishim pasqyrat financiare të 6-mujorit dhe raportin e kryetarit, s'i kishim mediat, e sot i gjetëm me i thirre. Është kritikë dhe mendojë që është me vend, nuk është pjesë e kësaj dhe po e thamë, kisha kërkua që ta shohim njëherë ta shikojmë se sa mundemi me ndryshu, deklaratën e mbështesim.

z.Taulant Haxhiu: Përsëndetje për të gjithë të pranishmit! Për mua është mandati i dytë, por kjo është një nga seancat më të rëndësishme të Komunës së Vitisë. Bëhet fjalë për shkollën “Halil Alidema”, kjo shkollë e bartë emrin e një veprimtari të madh, Pozherani është fshati më i madh ne Republikën e Kosovës, është fshati i dytë me numër të banorëve në Republikën e Kosovës dhe nxansat kanë mbet jashtë, prej vitit 2016 shkolla ka mbet e papërfundime. Unë i bëj thirrje kryeministrit të Republikës së Kosovës, ministres së arsimit edhe deputeteve të nderuar, znj.Mirlinda Sadiku-Tishukaj dhe Njazi Isaku, që të marrin sa më shpejt hapa, që qytetarët e Vitisë dhe Pozheranit ta gëzojnë shkollën e tyre. Një ashtu edhe Marigona Geci. Ne duhet të jemi të gjithë së bashku për të mirën e qytetareve, vjen shtatori, në qoftë se bëjmë protesta kanë me u qu krejt Pozherani në kam, i madh e i vogël edhe nuk kanë me mujt me kontrollu gjendjen Pozherani. Është fshati më i madh ne Komunën e Vitisë po edhe fshatrat më të mëdha në Republikën e Kosovës. Kërkoj nga ata për koordinim e asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, që të bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme që të përfitojnë qytetarët e Komunës së Vitisë. Dhe nen 2), çerdhja është kanë ë parapamë që të behet në Viti, Viti është vendbanim më i

madh se Kamenica, Vitia ka potencial më të madh se Kamenica, e ne ta tolerojmë një çerdhe që të shkojë në Kamenicë me lokacion shumë më të vogël, se Vitia e nesër fëmijët tanë të mbesin rrugëve pa çerdhe. E kemi një çerdhe po aq shumë që janë kërkesat, ne nuk kemi ku me i qu nxënësit. I kemi dhe 2 çerdhe private, po nuk ka mundësi të gjithë të regjistrohen. Unë kërkojë edhe njëherë nga të gjithë dhe nga Lëvizja Vetëvendosje si pjesë e pushtetit që ka ardh për ndryshim, ne të jetë ndryshimi i ri, duhet të bëni përpjekje për qytetarët tanë, nuk jemi tu fol për poena politik, jemi tu fol për qytetarët tanë. Ata kanë nevojë për çerdhe. Kjo duhet të vijë në Viti sa më parë. Nuk jemi kundër Kamenicës, po Vitia ka më shumë nevojë dhe unë pres që nga sot, nga kjo deklaratë e përbashkët, shkolla "Halil Alidema" të bëhet sa më parë, që nxënësit të fillojnë mësimin aty dhe çerdhja të vie për fëmijët tanë. Ne nuk kemi në shtatorë vende për fëmijët se ku t'i regjistrojmë, kemi shumë kërkesa po vende nuk kemi. Ju faleminderit për kohen!

z.Reshat Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë e mbështes këtë iniciativë, se është tejet e nevojshme përfundimi i shkollës "Halil Alidema" në Pozheran. Gjithashtu është e nevojshme të ndërtohet edhe çerdhja në Viti, po e kam një kërkesë pak më interesante. Këtë deklaratë ju lus ta ndryshoni shkaku i gabimeve gjuhësore, me të vërtet nëse qëkjo deklaratë shkon dikun është pak e turpshme sa gabime janë këtu. Unë kisha kërku me ndryshu këto gabime. Përshembull njashtu, dhe dhe përsëritet disa herë. Në përgjithësi deklaratën e mbështes.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht tashti na ka ardh një tjetër, domethënë që veç i vërejtëm ne gabimet, se nuk është kanë i lektorium, po derisa tæ kryhet lektorimi e prunem për me shpërnda për me pas të njohur formën e deklaratës dhe përmbajtjen.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kisha me thanë që shumë mirë më vie prej subjektit të Vetëvendosjes, të cilët na u bashkëngjiten për interes të gjithave të komunës jo për interes të vetin ose dikujt tjetër, po megjithatë kënaqësi me qenë së bashku. Unë e përshëndes këtë deklaratë plotësisht.

z.Ilir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sot më së paku do te doja te jem në cilësinë e asamblistit ne këtë seancë, ngase me vete kam peshën e një administratori, një prindi e një qytetari të Pozheranit. Sot përfaqësoj në këtë seancë mbi 500 nxënës e 1 mijë prindër, të cilët që nga viti 2016 janë pa shkollë në Pozheran. Prej seancës së parë deri më sot e kam ngritë çështjen e Pozheranit. Shumë njerëz kanë thanë pe shfrytëzojnë politikisht. Për hir të gjithëve, një deklaratë të prindërve e qytetareve të Pozheranit, drejtorisë së shkollës. Unë kam veç një lutje nga ti kryesues, unë do ta shpërndaj këtë dhe ju lus që për 2 minuta të mos ja japësh fjalës askujt që secili ta lexojë me ndjenjat e veta dhe ta shohin se çka hekin qytetarët dhe nxënësit e Pozheranit.

"Të nderuar asamblistë, pjesëmarrës në këtë seancë te jashtëzakonshme, ku po flitet për Shkollën Filllore "Halil Alidema" ne Pozheran, sot, më së paku do te doja te jem në cilësinë e asamblistit ne këtë seancë , ngase me vete kam peshën e një administratori, një prindi e një qytetari Pozheranas, i cili tanimë nuk donë të dijë për fajtorin. Kushdo mund te ketë faj, por dikush duhet ta zgjidhë këtë problem. Te nderuar asamblistë, fëmijët pozheranas tanimë janë përgjysmë të shkolluar e dyfish të diskriminuar, atyre ju mohohet mundësia e mësimi të rregullt sistematik, ngase 20 minuta të orës mësimore nuk mjaftojnë as për pjesën hyrëse apo motivuese të orës e as për pjesën reflektuese, por vetëm për pjesë zhvillimore e cila nuk mund të ketë as për së afërmi efektin e saj pa ato dy pjesët e tjera te orës mësimore. E them të diskriminuar ngase, nxënësit e Shkollës Filllore "Halil Alidema" në Pozheran nuk kanë asnjë mundësi të kenë qasje ne aktivitetet jashtëmësimore, te cilat janë jetike për avancimin e mëtejme social të një nxënësi. E kujtoj një moment te vështirë të një mësimdhënësi dhe drejtoreshës së kësaj shkolle, kur nuk arritëm të gjejmë hapësira për zhvillimin e projektit ndërkombëtar EDISON dhe u detyruan ta braktisin atë projekt. Padyshim se ishte ndër momentet më të vështira për mësimdhënësit e drejtoreshën, por edhe për mua si administrator që u gjeta ne një rrugë pa dalje, dhe u humb një mundësi e avancimit te shkollës

që rrallë herë mund të vije. Andaj, te dashur pjesëmarrës në këtë seancë, nga këtu bëjë thirrjen më të sinqertë që mund të kenë fëmijët, mësimdhënësit dhe prindërit pozheranas. Nuk na intereson të gjejmë fajtorin, neve na intereson zgjidhja e problemit, pra përfundimi i Sshkollës dhe fillimi i mësimi në të. Vëllezër e motra, të nderuara Institucione relevante, ju njerëz të vullnetit të mirë, fëmijët e klasës së parë nuk e njohin kryetarin e komunës, as ministrat e linjave, as operatorët ekonomik, as organin shqyrtues të prokurimit e as komisionin mbikëqyrës, ata sapo kanë filluar ta njohin mësuesen e tyre dhe alfabetin e Gjuhës Shqipe, e nëse nuk do të takohen ne shtator me mësuesen dhe me alfabetin e tyre, ata ndoshta pa dashje do të detyrohen ta njohin ndonjë mësuese të Gjuhës Gjermane apo ndonjë alfabet të një gjuhe tjetër diku ne skaj te botës, larg fëmijëve të lagjes, e larg prehërve të gjyshërve të tyre. Andaj, mos të lëmë gurë pa lëvizur deri në forcën e fundit”.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Një material, shqetësimet e fshatit, si këshilli i fshatit, si qytetarë, si banorë.

z.Illir Zuka: Nuk deshta me politizu asgjë, unë e lus që secili me ndjenjat e veta ne ta lexon.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne si grup i vetëvendosjes kërkojmë 5 minuta ose 10 minuta pushim për këtë çështje që të konsultohemi në mes veti.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht me lejoni që në emër të ekzekutives të ju falënderoj për mirëkuptimin të cilën e keni pas për këtë shqetësim, i cili nuk është shqetësim që plotësisht Jakupi të cilin e tha nuk është shqetësim që nga viti 2022 po që nga fillimi I punimeve. Ju e dini që shumë herë kjo temë diskutimi është ngritë në këtë asamble, pavarësisht përbërjes ka qenë brengë e secilit qytetarë të komunës sonë, që kjo shkollë me lokalitetin më të madh, në lokalitetin e shkollës së parë të Gjuhës Shqipe. Tasht pa dashtë nuk duhet me na interesu në këtë moment fajtori, po është tu na interesu krijimi I hapësirave sa më të mira edhe për nxënës edhe për personel shkollor, prandaj shefi I Grupit të Vetëvendosjes nuk është brengosese për ne që me paraqitë se prej fillimit është ai projekt neglizhencë, hiq nuk është problem, e keni kërku për atë atë pauzën po, edhe temën tjetër nëse doni ta diskutoni nuk është problem, ne jemi këtu, është me rendësi për çështjet të cilat janë në interes të qytetareve të komunës tonë, dhe një çështje me interes madhor të aspektit zhvillimit të jetës shoqërore. Në këtë rast të dy objektet janë shumë domethënëse, shkolla e Pozheranit po edhe çerdhja. Në rast se në plotë nevojën e kemi për punësim, si element i punësimit është çerdhja, nuk ki çerdhe s’ki ku e len fëmijën. Ty edhe me të ofru dikush punë, ti nuk mundësh. Në rast se e shikojmë diskutimin e shefit të grupit të PDK-së, ne duhet t’i krijojmë qytetareve tonë hapësirë, jo të gjejë punë e fëmijën s’ka kush ta ruaj, se në rast se paga e një dadoje është e barabartë me atë që punon, ajo e kqyrë vet fëmijën. Kur i krijojmë ne hapësira, çerdhe, edhe ka mundësi ajo për punësim. Unë konsiderojë se ne rast se një kuvend të cilët e thanë nuk ka asnjë paragjykim politik, po ka taman një realitet të përfshirjes së një gjendje të cilët e kemi në të dy rastet të komunës sonë, është ky, prandaj ju falënderojë për mirëkuptimin dhe ju kisha falenderu edhe në rast se dilni unanim nga ky kuvend, me këto kërkesa, pavarësisht tekstit të cilin mundeni me sqaru me vëmendjen e juaj. Unë kam bërë përpjekje së bashku me kryesuesin, me shefat, që me qenë një tekst të cilët me të vërtet ju drejtohet institucioneve përkatëse dhe dihet çka po kërkojmë, sa më i qartë, pa lëndime. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Nënkryetar, pasi qe deklaratën nuk e kishim, tekstin e deklaratës, ne kem atje. Unë kur shkova te zyra nuk munda me I taku pjesën më të madhe.

z.Ramadan Deliu: Kush të donë e voton, kush të donë nuk e voton. Unë mendoj që kjo nuk është asgjë personale, kjo është për popullin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Ramadan! Unë e kam për obligim ligjor, që gjithë me diskutu edhe në fund me mujt mu harmonizu sa më shumë me votu, se është në interes të përgjithshëm. Unë mendoj që 5 minuta pauzë duhet të jetë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit! Tani që jeni kthyer në sallë me konsultimin me grupet bashkë, te pjesa e ndryshimit mbetet kjo neglizhencë dhe mos efikasitet nga fillimi e deri më tani i përfundimit të punimeve, shpreh shqetësimet dhe vazhdon. Kjo ke domethënë kërkesa për ndryshim. Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e

Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 36, paragrafi 2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011. Kuvendi i Komunës së Vitisë, në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më datën 09.08.2022, miraton këtë deklaratë:

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë si këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, të zgjedhur nga ana e qytetarëve, se SHFMUL "Halil Alidema" në Pozharan duhet të përfundoj punimet sa më parë në mënyrë që nxënësve të ju krijoj hapësirë të mjaftueshme për mësimnxënie dhe aktivitete tjera mësimore dhe personelit arsimor kushte dhe hapësirë të mjaftueshme për ushtrimin e profesionit të shenjtë të tyre për mësimdhënie.

2. Njashtu edhe mënjanimi i projektit të çerdhes së re në Viti, që është domosdoshmëri për qytetarët tonë, të kthehet si projekt i ndarë më parë dhe të fillojnë procedurat e ritenderimit.

3. Kjo neglizhencë dhe mos efikasitet nga fillimi e deri më tani i përfundimit të punimeve shpreh shqetësimin e përfaqësuesve të institucioneve lokale, si përfaqësues të qytetarëve të Vitisë. Andaj ne përfaqësuesit e institucioneve lokale, në emër të gjithë qytetarëve të komunës sonë, nëpërmjet kësaj deklarate drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kërkujmë që të adresohet kërkesa dhe nevoja e nxënësve dhe prindërve të Komunës së Vitisë për përfundimin sa më parë të SHFMUL "Halil Alidema" në Pozheran dhe fillimin e nderimit të çerdhes së re në Viti.

4. Nisur nga arsyeshmëria e kërkesës dhe nevojës urgjente të qytetarëve, Kuvendi Komunal i Komunës së Vitisë, miraton këtë deklaratë, përmes të cilës KËRKON që, Qeveria e Republikës së Kosovës t'i shfrytëzoj mundësitë ligjore urgjentisht në përfundimin dhe realizimin e këtyre projekteve jetike për arsimin në Viti. Më 09.08.2022

Kjo është deklarata e hartume së bashku më të gjitha grupet, pas të gjitha diskutimeve, harmonizimeve, kërkojë nga të gjithë anëtarët e kuvendit unanimisht në interes të qytetareve të miratojmë këtë deklaratë. 22 janë prezentë, 22 janë pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:40 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Aziz
